



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.13/2024

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Skënder Çoçaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], me vendbanim në Toronto, Kanada, të parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së, me nr. Protokollit 01/2320/2024 datë 30.12.2024, për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.01.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.13/2024 datë 30.12.2024, e parashtruar nga [REDAKTUAR], me vendbanim në Toronto, Kanada, parashtruar kundër Vendimit me nr. Protokollit 01/2320/2024 datë 30.12.2024, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09 shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 30.12.2024, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë nga [REDAKTUAR], me vendbanim në Toronto, Kanada, në të cilën pretendohet se të njëjtit i është refuzuar ankesa për kundërshtim administrativ për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, edhe pse me datë 26.12.2024, ka aplikuar dy herë në faqen zyrtare të KQZ-së, me kërkesë që të votojë jashtë Kosovës, në konsullatën e Kosovës në Toronto. Parashtruesi thekson se letërnjoftimin e Kosovës nuk e ka me veti në Kanada, sepse thekson se ka dokumentet Kanadez dhe ka fotografuar letërnjoftimin e Kosovës në telefonin mobilë të tij si duket në foto të cilën ju kam derguar. Parashtruesi në ankesë thekson se i ka shkarkuar të gjitha dokumentet e identifikimit, letërnjoftimin në të dy anët me foton e tij, si dhe pasaportën Kanadeze.

Parashtruesi në ankesë ka bashkangjitur dëshmitë si kopje e letërnjoftimit, foton e letërnjoftimit në telefonin mobil, kopje të pasaportës Kanadeze, si dhe kopje të vendimit të KQZ-së, me nr. Protokollit 01/2320/2024 datë 30.12.2024.

PZAP, iu ka drejtuar me datë 01.01.2015 me kërkesë për përgjigje KQZ-së lidhur me ankesën A.nr.13/2024 të parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR].

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 02.01.2025 ka parashtruar në PZAP, përgjigje në kërkesë.

Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, ndër të tjera thuhet se “...se shtetasi [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike me datë 26.12.2024, ku i njëjti ka zgjedhur opsionin e votimit në përfaqësi diplomatike të votoj fizikisht në konsullatën e Republikës së Kosovës në Toronto, dhe ka bashkangjitur dëshmitë si kopje e letërnjoftimit, foton e letërnjoftimit në mobil, si dhe kopje të pasaportës kanadeze...se shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin me datë 28.12.2024 në ora 13:44 dhe aplikuesi është njoftuar përmes email-it, ...Mungon fotografia juaj me dokument identifikues të Kosovës në dorë”, meqë dëshmitë e bashkangjitura nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në rregulloren sikurse përcaktohet në paragrafin 3, të nenit të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimit Jashtë Kosovës, pika c), ku thuhet: “aplikuesi ngarkon fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës...” . Në përgjigje në ankese të KQZ-së, theksohet qe parashtruesi i ankesës, është i njoftuar me vendimin e KQZ-së, me datë 30.12.2024, ora 16:25.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në nenin 4 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave,

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, dhe vendimin nr.01/2320-2024 datë 30.12.2024 të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin nen të njëjtës Rregullore ndër të tjera thuhet se “Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ-së bëhet duke plotësuar dhe bashkangjitur:

- ***verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit - aplikuesi ngarkon fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës...;***

Nga shkresat e lëndës, si dhe nga përgjigja e KQZ-se, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformes elektronike të KQZ-së, pavarësisht faktit që aplikuesi kishte bashkangjitur disa dokumente të kërkuara si kopje të letërnjoftimit, dhe kopje të pasaportes kanadeze ai nuk ka plotësuar një nga kriteret e rëndësishme kriterin e verifikimit të dyfishtë të identitetit të votuesit të rregulluar me nenin 3.3.1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së.

Në aplikimin e tij, parashtruesi i ankesës kishte bashkangjitur kopje të letërnjoftimit dhe kopje të pasaportës kanadeze.

Megjithatë, përveç këtyre dokumenteve, sipas procedurave të KQZ-së, kërkohet një verifikim i dyfishtë i identitetit të votuesit. Ky kriter specifikon që aplikuesi duhet të ngarkojë një fotografi të tij, në të cilën ai duhet të mbajë dokumentin e tij të identitetit siç është letërnjoftimi në dorë, duke mundësuar që verifikimi të bëhet vizualisht dhe në mënyrë të kjartë.

Në rastin konkret, aplikuesi ka ngarkuar një foto të letërnjoftimit, por nuk ka plotësuar kërkesën e KQZ-së, për fotografi të vetvetes duke mbajtur dokumentin e identitetit. Ai ka dërguar një fotografi të dokumentit të letërnjoftimit që ka pasur në telefonin e tij, por kjo foto nuk ka përmbushur kërkesën e verifikimit të identitetit, pasi nuk përmbante elementin e domosdoshëm: aplikuesi të jetë i pranishëm në foto duke mbajtur dokumentin në dorë, dhe kjo ka rezultuar në mos plotësimin e kriterëve të rregulluara me Rregulloren Zgjedhore Nr. 17/2024, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3.3.1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës, neni 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 13/2025 më datën 03.01.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.